

## **SKK 1**

### **Prezentimi i pasqyrave financiare**

#### **Ardhje:**

1. Standardi përshkruan formën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve afariste të cilat duhen të përgatitin pasqyrën financiare për përdorues jashtë ndërmarrjes, përfshirë këtu autoritetet tatimore dhe statistikore, të punësuarit, dhe të tjerët të cilët mund të kenë interes legjitim në pozitën financiare dhe në afarizmin e ndërmarrjes.
2. Kërkesat e këtij Standardi janë të bazuara në Kornizën e IASC (Komitetit Ndërkombëtar të Standardeve të Kontabilitetit KNSK) për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare

#### **Qëllimi:**

3. Qëllimi i këtij standardi është që të parashkruaj parimet për prezentimin e pasqyrave financiare të publikuara, në mënyrë që të sigurohet një krahasueshmëri në mes të pasqyrave financiare, të periudhave të mëhershme të vet ndërmarrjes, si dhe në mes të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve tjera në Kosovë.

#### **Qëllimi i Pasqyrave Financiare**

4. Pasqyrat financiare janë një paraqitje e strukturuar financiare, dhe e transaksioneve që ndërmirren nga një ndërmarrje. Qëllimi i pasqyrave të publikuara financiare është për të ofruar informata rreth pozitës financiare, rezultateve të veprimtarisë, rrjedhën e parave (cash floës) në ndërmarrje, gjë që i shërben një numri përdoruesish që kanë interes legjitim në aftësinë e saj financiare. Pasqyrat financiare deri në një shkallë tregojnë edhe rezultatet e udhëheqjes me resurset të cilat i janë besuar menaxhmentit. Që të arrihet ky qëllim, pasqyrat financiare sigurojnë informata në lidhje me:
  - a. Pasuritë;
  - b. Detyrimet;
  - c. Ekutitetin;
  - d. Të ardhurat dhe shpenzimet; si dhe
  - e. Rrjedhën e parasë (cash floës), së ndërmarrjes.

#### **Përgjegjësia për Pasqyrat Financiare**

5. Bordi i drejtorëve dhe/apo organi qeverisës i një ndërmarrjeje është përgjegjës për prezentimin e pasqyrave të saja financiare.

### **Përbërësit e Pasqyrave Financiare**

6. Një pasqyrë financiare i kompletuar duhet të përfshijë sa vijon:
  - a) Një Pasqyrë të bilancit;
  - b) Një Pasqyrë të të ardhurave;
  - c) Një pasqyrë ku paraqiten të gjitha ndryshimet në ekuitetin;
  - d) Një Pasqyrë të rrjedhës së parasë (Cash floë); si dhe
  - e) Politikën kontabël dhe shënimet sqaruese.
7. Ndërmarrjet inkurajohen që së bashku me pasqyrën financiare të paraqesin një vështrim financiar nga ana e menaxhmentit, i cili përshkruan dhe sqaron karakteristikat kyçe të performancës financiare, si dhe pasiguritë kyçe me të cilat do të ballafaqohet ndërmarrja.
8. Ndërmarrjet e vogla të cilat nuk i nënshtrohen rregullores së fitimit mbi tatimin nuk duhet të përgatisin pasyrën e rrjedhës së parasë së gatshme e as pasyrën e ndryshimeve në ekuitetë.

### **Prezentimi fer dhe përputhshmëria me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës**

9. Pasqyrat financiare duhet të paraqesin në mënyrë të drejtë pozitën financiare, rezultatet financiare, si dhe rrjedhën e parave (cash floë) të një ndërmarrjeje. Aplikimi i Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës (SKK-së) me shpjegime të tjera shtesë sipas nevojës, rezulton në pasqyra financiare të cilat arrijnë një prezentim fer për shumicën e Ndërmarrjeve Kosovare nga të cilat pritët kërkohet të përgatisin publikimin e pasqyrave financiare.
10. Ndërmarrjet e mëdha, në kontekstin e ekonomisë së Kosovës, pasi që lejohen të adaptojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) në vend të SKK, përputhshmëria me SNK do të rezultojë në pasqyra financiare të cilat do të sigurojnë një prezentim të drejtë.
11. Ndërmarrjet duhet ta bëjnë të ditur faktin në rastet kur standardet e pasqyrave financiare të tyre janë në përputhshmëri me SKK. Kurse

ndërmarrjet pasqyrat financiare të së cilës janë në përputhshmëri me SNK, duhet të bëjnë të ditur këtë fakt, në pajtueshmëri me kërkesat e klauzulës 11 të SNK 1.

12. Në raste shumë të rralla kur menagjimenti do të konkludojë se përputhshmëria me udhëzimet e një Standardi do të shpie në fakte mashtruese, si dhe shmangia nga këto udhëzime do të jetë e nevojshme për të arritur një prezentim fer, duhet të bëhet shpalosja e një konkludimi të tillë, arsyet e mospërputhjes me udhëzimet e standardit si dhe efekti financiar në fitim apo humbjen neto, pasuri, detyrime, ekuitetë si dhe në rrjedhjen e parave (cash floë) për periudhën përkatëse.

### **Politikat Kontabël**

13. Menaxhmenti duhet të zgjedhë dhe të zbatojë politikat e kontabël të ndërmarrjes, kështu që pasqyrat financiare të jenë në përputhshmëri me të gjitha udhëzimet e secilit SKK. Aty ku ka mungesë të udhëzimeve të specifikuar, menaxhmenti duhet të krijojë politika që do të sigurojnë se pasqyrat financiare ofrojnë informata që janë:
- a. përkatëse për nevojat e vendimmarrjes së përdoruesve; dhe
  - b. të besueshme në mënyrë që të:
    - i) paraqesin në mënyrë të saktë rezultatet dhe pozitën financiare të ndërmarrjes;
    - ii) reflektojnë substancën ekonomike të ngjarjeve dhe transaksioneve e jo vetëm formën ligjore;
    - iii) janë neutrale, të lira nga paragjykimet;
    - iv) janë të arsyeshme; dhe
    - v) janë të kompletuara në të gjitha aspektet materiale

### **Parimi i vazhdueshmërisë së afarizmit**

14. Gjatë përgatitjes së pasqyrës financiare, menaxhmenti duhet të vlerësojë mundësinë e ndërmarrjes për të vazhduar veprimin e saj. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në bazë të Parimit të vazhdueshmërisë së afarizmit, përveç se në rastet kur menaxhmenti mendon të ndalë afarizmin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër reale përveç ndërprerjes. Në

një rast të tillë, pasqyra financiare nuk duhet të përgatitet në bazë të parimit të vazhdueshmërisë së afarizmit, si dhe një gjë e tillë duhet të tregohet si dhe të tregohet arsyeja pse ndërmarrja nuk është në përputhje me këtë parim.

### **Parimi aktual (i momentit të paraqitjes së transaksionit)**

15. Përveç informatave lidhur me rrjedhën e parasë, ndërmarrja duhet të përgatisë pasqyrën e saj financiare në bazë të parimit aktual (i momentit të paraqitjes së transaksionit) të kontabilitetit. Në bazë të këtij parimi, transaksionet dhe ngjarjet regjistrohen atëherë kur ato të ndodhin (e jo në momentin kur të pranohet apo paguhen paratë) në shenimet e kontabilitetit, si dhe prezentohen në pasqyra financiare të periudhës së cilës ato i përkasin.

### **Konsistenca e prezentimit**

16. Prezentimi dhe klasifikimi i zërave në pasqyrën financiare duhet të përcillet nga një periudhë në tjetrën.

### **Materialiteti dhe grumbullimi**

17. Të gjithë zërat material duhet të prezentohen ndaras në pasqyra financiare. Shumat jomateriale duhet të grumbullohen në shuma që i përkasin natyrës së njejtë apo funksionit të ngjashëm, dhe nuk nevojitet të prezentohen ndaras.
18. Pasqyrat financiare janë rezultat i përpunimit të një numri të madh të transaksioneve të cilat mbledhen sipas natyrës së tyre (p.sh. pagat, shpenzimet e vendqëndrimit) apo sipas funksionit (p.sh. shpenzimet administrative apo të shitjes). Një zë i cili nuk është aq i materializuar për t'u prezentuar posaçërisht në ballinën e pasqyrave financiare, mundet të jetë aq i materializuar sa të mund të prezentohet ndaras në shënimet sqaruese.
19. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e zërit të vlerësuar në rrethanat e posaçme të lënies së tij jashtë, apo në krahasim me zërat e tjerë të cilët vlerësohen së bashku.

### **Kundërpeshimi (offsetting)**

20. Pasuria dhe detyrimet nuk duhet të kundërpeshohen, përveç se në rastet kur kërkohet apo lejohet nga ndonjë tjetër SKK. Zërat e të ardhurave dhe të shpenzimeve duhet të kundërpeshohen vetëm kur një SKK e kërkon apo lejon atë.

### **Informatat krahasuese**

21. Informatat krahasuese për periudha paraprake duhet të shpalosen në pasqyra financiare. Informatat krahasuese duhet të përfshihen në informata sqaruese dhe përshkruese kur janë të rëndësishme për të kuptuar periudhën e tanishme të pasqyrës financiare.

### **Periudha raportuese**

22. Pasqyrat financiare duhet të prezentohen së paku një herë në vit. Kur nën rrethana të jashtzakonshme, data e pasqyrës së bilancit të ndërmarrjes ndryshon, dhe pasqyrat vjetore financiare paraqiten për një periudhë më të gjatë apo më të shkurtë se një vit, ndërmarrja duhet të publikojë arsyen për aplikimin e një periudhe tjetër, dhe se shumtat e krahasuara për pasqyrën fillestare financiare nuk janë të krahasueshme përveç se pasqyra e bilancit.

### **Pasqyra e bilancit**

23. Secila ndërmarrje duhet të paraqes pasurinë kurente dhe atë jo kurente, si dhe detyrimet kurente dhe ato jo kurente si klasifikime të veçanta në pasqyrën e bilancit.

### **Pasuria kurente**

24. Pasuria duhet të klasifikohet si pasuri kurente kur:
- a. pritët që të realizohet, apo mbahet në shitje ose konsumohet gjatë kohëzgjatjes së ciklit normal veprues të ndërmarrjes; apo
  - b. mbahet kryesisht për qëllime tregtare, apo për një afat të shkurtër, dhe që pritët të realizohet brenda dymbëdhjetë muajve të datës së pasqyrës së bilancit; ose
  - c. është para e gatshme që ka kufizime për tu përdorur.

Të gjitha pasuritë tjera duhet të klasifikohen si pasuri jo kurente.

### **Detyrimet kurente**

25. Detyrimi duhet të klasifikohet si detyrim kurent kur:
- a. pritët që të shlyhet gjatë kohëzgjatjes normale të ciklit veprues së ndërmarrjes; apo

- b. pritet që të shlyhet brenda 12 muajve nga data e shënuar në pasqyrën e bilancit.

Të gjitha detyrimet tjera duhet të klasifikohen si detyrime jo kurente.

### **Informatat që duhet prezentuar në fletën e pasqyrës së bilancit apo në shënime**

- 26. Pasqyra e bilancit duhet të përfshijë së paku këta zëra të renditur:
  - a. Palujtshmëritë, impiantet dhe pajisjet;
  - b. Pasuria e paprekshme;
  - c. Stoqet;
  - d. Tregëtimi dhe të arkëtueshmet e tjera;
  - e. Keshi (paratë e gatshme);
  - f. Investimet d.m.th. depozitat e afatizuara
  - g. Të pagueshmet e tregut dhe të tjerat; detyrimet tatimore dhe;
  - h. Provizionet;
  - i. Interesin nga detyrimet jo kurente;
  - j. Kapitalin e emetuar dhe rezervat.
- 27. Nën-klasifikimet e mëtejme të zërave të paraqitur në pasqyrën e bilancit, apo në shënime, duhet të shfaqen në pasqyrën e bilancit, apo në shënime, nëse një prezentim i tillë nevojitet për të paraqitur pozitën financiare të ndërmarrjes në mënyrë të drejtë. Zërat tjerë shtesë, titujt, dhe nëntotalet, duhet të paraqiten në pasqyrën e bilancit kur ndonjë SKK tjetër e kërkon këte.
- 28. Një ndërmarrje duhet të shfaqë në pasqyrën e bilancit, apo në shënimet e pasqyrë financiare se a ka shuma për tu paguar, apo për tu pranuar nga ndërmarrja prind, partnerët subvencionues, si dhe palët e tjera të ndërlidhura, përfshirë të punësuarit dhe drejtorët.

### **Pasqyra e të ardhurave**

## **Informatat që duhet paraqitur në pasqyrën e të ardhurave apo në shënime tjera**

29. Pasqyra e të ardhurave duhet së paku të përfshijë këta zëra:
- a. të hyrat nga veprimtaria;
  - b. kategoritë themelore të shpenzimeve nga veprimtaria;
  - c. fitimi apo humbja nga veprimtaria;
  - d. kostot financiare;
  - e. të shpenzimeve e tatimit mbi fitimin;
  - f. të hyrat tjera;
  - g. zërat e jashtëzakonshëm; dhe
  - h. fitimi neto apo humbja për periudhën.
30. Nënklasifikimet e mëtejme të zërave të paraqitura në pasqyrën e bilancit duhet të shfaqen në pasqyrën e bilancit, apo në shënimet, nëse një prezentim i tillë nevojitet për të paraqitur në mënyrë të drejtë pozitive financiare të ndërmarrjes. Zëra tjerë shtesë, tituj, dhe nën totale duhet të paraqiten në pasqyrën e bilancit kur ndonjë SKK tjetër e kërkon këtë.
31. Ndërmarrja duhet të publikojë një analizë të shpenzimeve në shënimet e saj të pasqyrës financiare, duke shfrytëzuar klasifikimin që bazohet në natyrën e shpenzimeve, apo në funksionin e tyre brenda ndërmarrjes.
32. Ndërmarrja duhet të publikojë vlerën e dividendës për një aksion, të deklaruar apo propozuar, për periudhën të cilën pasqyra financiare e mbulon.

## **Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet**

33. Ndërmarrja duhet të publikojë si komponentë të posaçme në pasqyrën e saj financiare pasqyrën e cila shfaqë fitimin neto apo humbjen për atë periudhë, transaksionet kapitale dhe shpërndarjet pronarëve, dhe lëvizjet në të gjitha kontot rezervë, si dhe kontot tjera të ekuitetit duke përfshirë harmonizimin e bilancit fillestarë dhe atij përfundimtarë të secilit komponent të ekuitetit.

- 34) Ndërmarrjet e vogla të cilat nuk l nënshtrohen rregullores së fitimit mbi tatimin nuk duhet të përgatisin pasyrën e rrjedhës së parasë së gatshme e as pasyrën e ndryshimeve në ekuitetë.

### **Pasqyra e rrjedhës së parasë**

35. SKK 8 “Pasqyra mbi rrjedhën e parasë së gatshme” përcakton kërkesat për prezentimin e pasqyrës së rrjedhjes së parasë si dhe shpalosjet në lidhje me to.

### **SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

36. Shënimet në pasqyra financiare të një ndërmarrjeje duhet:
- a. të paraqesin informata për bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare si dhe politikave specifike të kontabël, të zgjedhura dhe vëna në veprim për transaksionet dhe ngjarjet me rëndësi;
  - b. të zbulojnë informata që kërkohen nga SKK-ja, e që nuk janë të paraqitura diku tjetër në pasqyrat financiare; dhe
  - c. të sigurojnë informata shtesë të cilat nuk paraqiten në fletë të pasqyrave financiare por që janë të nevojshme për të bërë paraqitje të drejta.
37. Shënimet në pasqyrat financiare duhet të paraqiten në mënyrë të sistematizuar. Çdo zë në fletën e pasqyrës së bilancit, pasqyrës së të ardhurave, dhe pasqyrës së rrjedhjes së parave, duhet të ketë refercën e kryqëzuar për secilën informatë në shënime përkatëse.

### **Paraqitja e Politikave Kontabël**

38. Pjesa e shënimeve ku paraqitet politika e përndjekur e kontabël gjatë përgatitjes së pasqyrës financiare duhet të përshkruaj siç vijon:
- (a) Bazën (bazat) e llogaritjes që është shfrytëzuar në përgatitjen e pasqyrës financiare; dhe
  - (b) Secilën politikë kontabël e cila është e nevojshme për të kuptuar në mënyrë të drejtë pasqyrën financiare.
39. Evidentimi i gabuar apo jo përkatës në pasqyrën e bilancit, e të ardhurave si dhe të rrjedhës së parave nuk mund të përmirësohet me publikimin e një shënimi sqarues apo politike të kontabël.

**Shpalosjet tjera**

40. Ndërmarrja duhet të bëjë këto shpalosje në vijim, nëse këto nuk janë shpalosur diku tjetër në informatat e publikuara në pasqyrën financiare:
- (a) Vendin e themelimit, formën ligjore dhe adresën e selisë kyçe të veprimtarisë së ndërmarrjes.
  - (b) Përshkrimin e natyrës së veprimtarisë së ndërmarrjes, dhe aktivitetet e saja kyçe; si dhe
  - (c) Numrin e të punësuarëve në fund të periudhës.

**Hyrja në fuqi**

41. Ky standard do të hyjë në fuqi dhe do të përfshijë pasqyrat financiare që përfshijnë periudhat të cilat fillojnë me 1 Janar të vitit 2002 apo pas tij. Rekomandohet aplikimi i mëhershëm i këtij standardi.

**SHTOJCA A.1.a**  
**Kompania ABC**  
**Pasqyra e Bilancit më 31 Dhjetor 2000**

DM'000

<b>Pasuritë</b>	<b>Shënimet</b>	<b>2000</b>	<b>1999</b>
Pasuritë kurente:			
Keshi (Paratë e gatshme në bankë)			
dhe në dorë	x1	250	850
Depozitët në Bankë		50	250
Kontot e arkëtueshme	x2	2,300	2,100
Stoqet	x3	1,900	2,250
Shpenzimet e parapaguara	x4	150	80
Totali i pasurive kurente		4,650	5,530
Pasuritë jo kurente:			
Palujtshmëritë, impiantët dhe			
Pajimet:	x5	4,960	4,750
Pasuritë e dhëna në lizing:	x6	890	500
Investimet:	x7	50	50
Totali i pasurive jo kurente:		5,900	5,300
<b>Totali i pasurive</b>		<b>10,550</b>	<b>10,830</b>
<b>Minus: Detyrimet</b>			
Detyrimet kurente:			
Mbitërheqje bankre		50	0
Llogari të pagueshme		4,150	4,910
Shpenzimet e grumbulluara	x8	420	650
Pjesa kurente për lizinget kapitale	x11	100	220
Dividendët e pagueshëm		100	100
Tatimi mbi fitim I pagueshëm	x9	100	80
Totali i detyrimeve kurente		4,920	5,960
Detyrimet kurente:			
Huatë	x10	250	0
Obligimet për lizingjet kapitale	x11	750	600
Totali i detyrimeve jo kurente		1,000	600
<b>Totali i Detyrimeve</b>		<b>5,920</b>	<b>6,560</b>
<b>PASURITË NETO</b>		<b>4,630</b>	<b>4,270</b>
<b>Përfaqësuar nga:</b>			
Kapitali i emtuar	x12	100	80
Rezervat	x13	100	90
Fitimi i mbajtur	x14	4,430	4,100
<b>Totali i ekuitetit</b>		<b>4,630</b>	<b>4,270<sup>1</sup></b>

<sup>1</sup> Paraqitja e pasqyrës e bilancit është e pranueshme sipas formës së paraqitur në A.1.a apo sipas A.1.b

**SHTOJCA A.1.b**

**Kompania ABC**  
**Pasqyra e Bilancit më 31 Dhjetor 2000**

DM'000

<b>Pasuritë</b>	<b>Shënimet</b>	<b>2000</b>	<b>1999</b>
<b>Pasuritë kurente:</b>			
Paratë e gatshme (Keshi) në bankë dhe në dorë	x1	250	850
Depozitët në Bankë		50	250
Kontot e arkëtueshme	x2	2,300	2,100
Stoqet	x3	1,900	2,250
Shpenzimet e parapaguara	x4	150	80
<b>Totali i pasurive kurente</b>		<b>4,650</b>	<b>5,530</b>
<b>Pasuritë jokurente:</b>			
Palujthshmëritë, impiantet dhe Pajimet: x5	4,960	4,750	
Pasuritë e dhëna në lizing:	x6	890	500
<b>Investimet afatgjate:</b>			
Depozitet e afatizuara	x7	50	50
<b>Totali i pasurive jo kurente:</b>	5,900	5,300	
<b>Totali i pasurive</b>		<b>10,550</b>	<b>10,830</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet kurente:</b>			
Mbitërheqje bankare		50	0
Kontot e pagueshme		4,150	4,910
Shpenzimet e grumbulluara	x8	420	650
Pjesa kurente për lizinget kapitale	x11	100	220
Dividendët e pagueshëm		100	100
Tatimi mbi fitim i pagueshëm	x9	100	80
<b>Totali i detyrimeve kurente</b>		<b>4,920</b>	<b>5,960</b>
<b>Detyrimet jo kurente:</b>			
Huatë	x10	250	0
Obligimet për lizinget kapitale	x11	750	600
<b>Totali i detyrimeve jo kurente</b>		<b>1,000</b>	<b>600</b>
<b>Totali i Detyrimeve</b>		<b>5,920</b>	<b>6,560</b>
<b>Kapitali dhe rezervat:</b>			
Kapitali i emtuar	x12	100	80
Rezervat	x13	100	90
Fitimi i mbajtur	x14	4,430	4,100
<b>Totali i ekuitetit</b>		<b>4,630</b>	<b>4,270<sup>2</sup></b>
<b>GJITHSEJT DETYRIME DHE EKUITET</b>		<b>10,550</b>	<b>10,830</b>

<sup>2</sup> Paraqitja e pasqyrës e bilancit është e pranueshme sipas formës së paraqitur në A.1.a apo sipas A.1.b

**SHTOJCA A.2**  
**Kompania ABC**  
**Pasqyra e të ardhurave për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2000**

	Shenimet	DM'000	
		2000	1999
<b>Shitjet</b>		<b>14,250</b>	<b>10,350</b>
Zvogëluar për: Lirimet në shitje		(500)	(200)
Shitjet e kthjera		(120)	(50)
Shitjet neto		13,630	10,100
<b>Shpenzimet e mallërrave të shitura</b>	<b>z1</b>	<b>(8,960)</b>	<b>(6,600)</b>
<b>Fitimi Bruto</b>		<b>4,670</b>	<b>3,500</b>
Shpenzimet operuese:			
Shpenzimet e shitjes			
Pagat dhe mëditjet		(1,050)	(800)
Komisionet		(120)	(100)
Shpenzimet e reklamës		(140)	(80)
Shpenzimet e shitjes së furnizimeve		(80)	(50)
Zhvlerësimi i orendive dhe paisjeve të dyqanit	x5	(80)	(50)
Shpenzimet e Përgjithshme dhe Administrative			
Pagat dhe mëditjet		(1,300)	(1,000)
Shpenzimet e borxheve të këqia		(400)	(250)
Shpenzimet e furnizimeve të zyrës		(200)	(150)
Zhvlerësimi i orendive dhe paisjeve të zyrës	x5	(80)	(50)
Zhvlerësimi i ndërtesës	x5	(100)	(100)
Shpenzimet e sigurimit		(220)	(100)
Shpenzimet e komunalieve (elektriciteti, telefoni)		(140)	(90)
Totali i shpenzimeve operuese		(3,910)	(2,820)
<b>Të ardhurat operuese</b>		<b>760</b>	<b>680</b>
Të ardhurat tjera:			
E ardhura nga dividenda		20	20
E ardhura nga interesi		90	110
Shpenzimet tjera:			
Shpenzimet e interesit		(250)	(150)
Shpenzimet nga tatimi në fitim	x9	(190)	(220)
<b>Të ardhurat neto të këtij vitit</b>	<b>z2</b>	<b>430</b>	<b>440</b>

**SHTOJCA A.3**  
**Kompania ABC**

**Rrjedhja e parasë së gatshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2000**

	Shenimet	2000	1999
<b>Rrjedhja e parasë së gatshme nga aktivitetet vepruese</b>			
Pranimi i parave të gatshme (keshit) nga konsumatorët		14,050	10,100
Zvogëluar për: Paratë e paguara furnizuesve dhe të punësuarëve		(13,910)	(9,220)
Paratë e gatshme që gjenerohen nga veprimet	y1	140	880
Interesi i paguar		250)	(170)
Tatimi mbi fitim i paguar		(170)	(240)
<i>Paratë e gatshme neto nga aktivitetet vepruese</i>		<i>(200)</i>	<i>470</i>
<b>Rrjedhja e parasë së gatshme nga aktivitetet investive</b>			
Blerja e patundshmërisë, fabrikës dhe paisjeve	x5	(690)	(250)
Rezultati i shitjes se pasurive fikse	x5	300	50
Interesi i pranuar		90	120
Devidenda e pranuar		20	20
<i>Paratë neto (të përdorura) në aktivitetet Investive</i>		<i>(280)</i>	<i>(60)</i>
<b>Rrjedhja e parasë së gatshme nga aktivitetet financuese</b>			
Rezultati nga leshimi i akcioneve në kapital	x12	20	0
Rezultati nga huamarrja		250	0
Pagesa e detyrimeve për lizingun		(460)	(180)
Devidenda e paguar		(100)	(100)
<i>Paratë e gatshme të përdorura/gjeneruara në aktivitetet financuese</i>		<i>(290)</i>	<i>(280)</i>
<b>Neto ngritjet/(zbritjet) në para të gatshme dhe ekuivalentët</b>		<b>(850)</b>	<b>130</b>
<b>Paratë e gatshme në fillim të periudhës</b>		<b>1,100</b>	<b>970</b>
<b>Paratë e gatshme në fund të periudhës</b>	<b>x1</b>	<b>250</b>	<b>1100</b>

**SHTOJCA A.4**  
**Kompania ABC**  
**Pasqyra e ndrrimeve në ekuitet**  
**për vitin i cili përfundon me 31 Dhjetor 2000**

	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>Ngritja e pagesave aksionare</b>	<b>Rezervat e rivlerësimit</b>	<b>Fitimet e mbajtura</b>
Bilanci me 31/12/98	65	15	90	3,760
Fitimi neto për periudhën				440
Dividendat				(100)
Bilanci më 31/12/99	65	15	90	4,100
Teprica nga rivlerësimi			10	
Emetimi i kapitalit aksionar	10	10		
Fitimi neto për periudhën				430
Dividentat				(100)
<b>Bilanci më 31/12/00</b>	<b>75</b>	<b>25</b>	<b>100</b>	<b>4,430</b>

**SHTOJCA A.5**  
**Kompania ABC**  
**Shënimet dhe pjesa përbërëse e**  
**Pasqyrës Financiare**  
**për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2000**

**1. Deklaratat mbi politikat e aplikuara esencilae kontabël**  
**a) Principet e Përgjithsme të Kontabilël**

**Bazat e përgatitjes**

Pasqyra financiare është raport financiar për qëllime të përgjithshme i cili përgatitet në pajtueshmëri me Standardet e aplikueshme të kontabilitetit dhe kërkesat tjera raportuese të detyrueshme dhe statutore.

Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në pajtim me konventën historike të shpenzimeve, përveç disa pasurive kurente, të cilat regjistrohen sipas vlerës.

Politikat e kontabilitetit janë të aplikuar në mënyrë të vazhdueshme, përveç se në rastet kur vendoset ndryshe, atëherë duhet të jenë në harmoni me ato të adaptuara për vitin e kaluar financiar.

**Periodha raportuese dhe krahasueshmëria**

(nëse periodha është më e shkurtë se një vit dhe do të ndikojë në krahasueshmëri atëherë duhet të deklarohet).

**b) Përmbledhje e Politikave të Kontabilitetit**

**Principet e konsolidimit**

(nëse pasqyrat financiare janë konto të konsoliduara, atëherë informatat rreth parimit të konsolidimit duhet të deklarohen)

**Të arkëtueshmet**

Tregëtia dhe borxhlinjtë e tjerë regjistrohen në pasqyrën e bilancit në shumën e të cilën duhet ta paguajnë. (Shenimin i referuar..).

Gjithashtu duhet të shenohet se a ka provizione për borxhet e dyshimta, parimi i vlerësimit të provizioneve dhe tretmani i borxheve të këqija, p.sh. fshirja kundrejt provizionit apo si ngarkesë në pasqyrën e të ardhurave.

**Investimet**

(Duhet të përcaktohet parimi i vlerësimit të investimeve të tanishme dhe atyre afatgjate).

**Stoqet**

Inventari përfshinë shkresori (materialin harxhues të zyrës), furnizimet dhe punën në vazhdim. (duhet t'i referoheni shenimit përkatës); gjithashtu duhet të vendoset parimi sipas së cilit bëhet vlerësimi i zërave të ndryshëm të inventarit.

#### **Prona, Fabrika, dhe Paisjet**

(politikat e pronësimit, kapitalizimit dhe vlerësimit të secilës kategori të pasurive fikse, të shlyerjeve si dhe amortizimit/zhvleftësimit duhet të deklarohet).

#### **Shpenzimet e mirëmbajtjes**

Duhet të deklarohet se a ngarkohen të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes në Pasqyrën e të Ardhurave apo në Provizionet kur ato të ndodhin, pavarësisht se a janë ato rutinore/vazhdueshme apo ciklike sipas natyrës.

#### **Kontot për tu paguar**

Duhet të përcaktohet parimi i pranimit dhe vlerësimit.

#### **Huamarrjet**

Duhet të deklarohet parimi i vlerësimit dhe trajtimit të çfarëdo premie apo lirimi, si dhe a pranohet interesi apo shpenzimet tjera të huamarrjeve nëpërmjet Pasqyrës së të Ardhurave, apo kapitalizohen në përputhje me standardet e kontabilitetit.

#### **Njohja e të ardhave**

Duhet të përcaktohet parimi sipas së cilës do të bëhet pranimi i zërave themelor të të ardhave.

#### **Shndrrimi i monedhave të huaja**

Duhet të përcaktohet parimi i shndrrimit të monedhave të huaja, të kurseve të shkëmbimit si dhe tretmani i fitimit apo humbjes ai rezultat i shndrrimit.

#### **c) Ndryshimet në politikat e kontabilitetit**

(çdo ndryshim i politikave të lartëpërmendura duhet të deklarohet këtu).

## **2. FITIMI OPERUES**

Këtu përfshihen detajet e kategorive kyçe të të ardhurave, të ardhave dhe shpenzimeve, p.sh. të ardhurat operuese, të ardhurat nga interesi, shpenzimet e huamarrjës, ngarkesat nga zhvlerësimi, dhe përfitimet apo humbjet nga shlyerja e pasurive kurente.

## **3. ZËRAT ABNORMAL DHE/OSE TË JASHTZAKONSHËM**

(Çdo zë duhet të shfaqet në shumën neto pas tatimeve përkatëse)

**4. TATIMI NË FITIM**

Duhet të deklarohet norma e tatimit gjatë kalkulimit të shpenzimeve të tatimit në fitim si dhe harmonizimi në mes tatimit të kalkuluar në fitimin e llogaritur si dhe ndryshimet në diferenca kohore për të arritur në shpenzimet tatimore bazuar në fitimin e tatueshëm.

**5. TË ARKËTUESHMET**

Duhet të deklarohen detajet e zërave për tu arkëtuar si dhe provizionet për borxhet e këqija nëse ekzistojnë.

**6. INVESTIMET**

Tregon kategoritë e investimeve kyçe, të tanishme dhe afatgjata, përfshirë këtu kushtet dhe gjëndjen përkatëse.

**7. INVENTARI**

Tregon detajet e kategorive të zërave të inventarit si dhe parimin e vlerësimit.

**8. PRONA, FABRIKA DHE PAJISJET**

Tregon kategoritë e pronës, fabrikave dhe paisjeve, bazën e vlerësimit (p.sh. koston apo vlerësimin) dhe zhvleftësimin e akumuluar të secilës kategori.

**9. KONTOT PËR TU PAGUAR**

Tregon detajet e zërave për tu paguar si dhe kushtet dhe rrethanat e tjera të rëndësishme.

**10. HUAMARRJET**

Tregon të gjitha huamarrjet, përfshirë huamarrjet nga banka, si dhe kushtet dhe rrethanat e tjera të rëndësishme për secilën kategori.

**11. PROVIZIONET**

Tregon balansin për secilën konto të provizionit përveç të atyre që janë përfshirë diku tjetër, duke i dalluar në mes të atyre të xhiros apo dhe atyre themelore.

**12. DEVIDENTA**

Tregon totalin e shumës së siguruar në pasqyrë me fitimin për periudhën dhe shumën aktuale të paguar përgjatë vitit.

**13. Pjesëmarrja në Kapital**

Tregon numrin e pjesëmarrjeve, sipas vlerës dhe çfarëdo ndryshimesh nëse ato aplikohen.

**14. REZERVAT**

Tregon kategori të ndryshme të Rezervave dhe lëvizjet gjatë periudhës

**15. ZOTIMET**

Tregon zotimet për shpenzime kapitale, lizing financiar dhe operues.

**16. HARMONIZIMI I RRJEDHJËS SË ARKËS**

Tregon harmonizimin në mes të rezultatit operues pas tatimeve dhe rrjedhjes së arkës së gjeneruar/shfrytëzuar në operime për çdo Pasqyrë të Rrjedhjes së arkës.

**17. TRANSAKSIONET E PALËVE TË NDËRLIDHURA**

Tregon borxhet dhe avanset për, dhe kontrata biznesore me, drejtorët, të punësuarit e lartë, dhe bizneseve të ndërlidhura nëpërmjet drejtorëve të rëndomtë apo pronarëve.

**18. DETYRIMET PËR TË PAPRITURAT**

Përshkruan çdo detyrim për të papriturat kryesore, siç janë rastet në gjyq apo garancioni e dhëna në emër të palëve të ndërlidhura.

**19. NGJARJET PËRCLJELLËSE ME DATËN E BILANCIT**

Përshkruan ngjarjet që mund të kenë ndikim me rëndësi për ndërmarrjen, posaçërisht në rezultatet financiare, dhe pozitën financiare për periudhën për të cilën raportohet.